

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR BANKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka si qëllim rregullimin bashkëkohor të statusit, objektivave, funksioneve, organizimit dhe qeverisjes së Bankës së Shqipërisë, si banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nevojën për forcimin e pavarësisë institucionale, funksionale, financiare dhe personale të saj, si dhe me standardet e Bashkimit Evropian për bankat qendrore kombëtare.

Projektligji synon përafrimin e kuadrit ligjor për Bankën e Shqipërisë me parimet themelore të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, veçanërisht sa i përket objektivit parësor të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, mbështetjes së politikave të përgjithshme ekonomike pa cenuar këtë objektiv, pavarësisë së bankës qendrore, ndalimit të financimit monetar të sektorit publik, si dhe ushtrimit të detyrave bazë të bankës qendrore në fushën e politikës monetare, operacioneve valutore, administrimit të rezervave valutore dhe funksionimit të sistemeve të pagesave.

Në këtë kuadër, projektligji synon të përcaktojë qartë objektivat dhe detyrat e Bankës së Shqipërisë, të konsolidojë garancitë ligjore për pavarësinë e saj në vendimmarrje dhe në administrimin e burimeve financiare, të forcojë rregullat për qeverisjen, llogaridhënien dhe transparencën institucionale, si dhe të sigurojë që marrëdhëniet e Bankës me Qeverinë dhe subjektet e tjera publike të zhvillohen në përputhje me parimin e bashkëpunimit institucional, pa cenuar ndalimin e financimit monetar dhe autonominë e bankës qendrore.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm është krijimi i bazës ligjore të nevojshme për integrimin gradual të Bankës së Shqipërisë në arkitekturën monetare dhe institucionale të Bashkimit Evropian, përfshirë pjesëmarrjen e saj të ardhshme në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe, në një fazë të mëvonshme, në Eurosistem. Për këtë arsye, projektligji parashikon dispozita të posaçme që do të zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe nga data e adoptimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë.

Nëpërmjet këtyre rregullimeve, projektligji synon të garantojë një kuadër ligjor të qartë, të qëndrueshëm dhe të harmonizuar me standardet evropiane, i cili mundëson ushtrimin efektiv të funksioneve të Bankës së Shqipërisë, forcimin e besueshmërisë së saj institucionale dhe përgatitjen e saj për detyrimet që rrjedhin nga procesi i integrit evropian të Republikës së Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji i propozuar, i hartuar nga Banka e Shqipërisë, megjithëse nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve që paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026, është në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë shqiptare në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe me detyrimet që rrjedhin nga negociatat për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Projektligji lidhet drejtpërdrejt me Kapitullin 17 “Politika ekonomike dhe monetare”, i cili është pjesë e Grupkapitullit 3 “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”. Ky kapitull përfshin, ndër të tjera, kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian për pavarësinë e bankës qendrore, ndalimin e financimit monetar të sektorit publik, ndalimin e aksesit të privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare, bashkërendimin e politikave ekonomike, si dhe përafrimin gradual me kuadrin juridik të Bashkimit Evropian në fushën monetare.

Në këtë kuadër, projektligji përbën një iniciativë ligjore të nevojshme për adresimin e rekomandimeve dhe piketave të përcaktuara në procesin e negociatave për Kapitullin 17, duke synuar përafrimin e plotë të kuadrit ligjor shqiptar për bankën qendrore me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.

Përmbajtja e projektligjit është në harmoni me objektivat politike dhe institucionale për forcimin e shtetit të së drejtës, konsolidimin e institucioneve të pavarura, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike, si dhe forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe financiar. Në veçanti, projektligji kontribuon në krijimin e një kuadri ligjor të qëndrueshëm për ushtrimin e pavarur dhe efektiv të funksioneve të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me standardet evropiane për bankat qendrore kombëtare.

Miratimi i këtij projektligji vlerësohet si i nevojshëm për përmbushjen e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe për përgatitjen e Bankës së Shqipërisë për pjesëmarrjen e saj të ardhshme në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe, në një fazë të mëvonshme, në Eurosistem.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji paraqitet si i nevojshëm për përditësimin dhe konsolidimin e kuadrit ligjor që rregullon statusin, objektivat, funksionet, organizimin dhe qeverisjen e Bankës së Shqipërisë, në kushtet e zhvillimeve të reja institucionale, financiare, si dhe një hap i domosdoshëm në kuadrin e procesit të integritimit evropian të Republikës së Shqipërisë. Përparësia kryesore e projektligjit qëndron në forcimin e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë, si kusht themelor për ushtrimin efektiv të funksioneve të bankës qendrore. Projektligji synon të garantojë pavarësinë institucionale, funksionale, financiare dhe personale të Bankës, duke përcaktuar qartë ndalimin

e kërkimit ose marrjes së udhëzimeve nga institucione apo subjekte të tjera, si dhe detyrimin e këtyre të fundit për të respektuar pavarësinë e Bankës së Shqipërisë.

Projektligji adreson gjithashtu nevojën për harmonizimin e kuadrit ligjor vendas me kërkesat e Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian dhe të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.

Në këtë drejtim, ai sanksionon në mënyrë eksplicite si objektiv parësor të Bankës së Shqipërisë arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, parashikon ndalimin e financimit monetar të sektorit publik dhe ndalimin e aksesit të privilegjuar, qartëson funksionet bazë të bankës qendrore, si dhe përfshin rregullimet e detyrueshme ligjore në kuadër të integritetit të ardhshëm të Bankës së Shqipërisë në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe në Eurosistem.

Një tjetër përparësi e projektligjit është qartësimi i hierarkisë së objektivave të Bankës së Shqipërisë, si dhe detajimi i detyrave të saj, përfshirë formulimin dhe zbatimin e politikës monetare, administrimin e rezervës valutore, nxitjen e funksionimit të sigurt dhe efikas të sistemeve të pagesave, emetimin e monedhës, mbikëqyrjen bankare dhe kontributin në ruajtjen e stabilitetit financiar. Ky qartësim shmang paqartësitë interpretuese dhe krijon një bazë më të qëndrueshme për ushtrimin e kompetencave publike të Bankës.

Projektligji synon të zgjidhë problematikat që lidhen me nevojën për një kuadër më të plotë dhe të përditësuar të qeverisjes së Bankës së Shqipërisë. Ai parashikon rregulla më të qarta për organet drejtuese, kriteret e emërimit, papajtueshmëritë, konfliktin e interesit, mbarimin e mandatit, procedurat e vendimmarrjes, llogaridhënien, transparencën dhe kontrollin e brendshëm e të jashtëm. Këto rregullime pritet të forcojnë integritetin institucional dhe besueshmërinë publike në vendimmarrjen e Bankës.

Miratimi i tij pritet të sjellë forcimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së Bankës së Shqipërisë, rritjen e qartësisë ligjore në ushtrimin e funksioneve të saj, përmirësimin e mekanizmave të qeverisjes dhe administrimit, si dhe rritjen e përputhshmërisë së kuadrit ligjor shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian për bankat qendrore kombëtare.

Në aspektin praktik, projektligji pritet të kontribuojë në forcimin e stabilitetit monetar dhe financiar, në rritjen e efektivitetit të politikës monetare, në ruajtjen e disiplinës fiskale përmes ndalimit të financimit monetar, si dhe në përgatitjen e Bankës së Shqipërisë për detyrimet që do të rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe, në një fazë të mëvonshme, nga pjesëmarrja në Bashkimin Monetar Evropian.

Projektligji krijon një kuadër më të qartë, më të parashikueshëm dhe më të harmonizuar me standardet evropiane, duke mbështetur stabilitetin e sistemit financiar dhe forcimin e besimit në institucionin e bankës qendrore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me nenet 78, 81, pika 2, shkronja “a” dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji është hartuar në respektim të parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës, ligjshmërisë, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe të parimit të pavarësisë së institucioneve publike që ushtrojnë funksione të posaçme me rëndësi për rendin kushtetues dhe stabilitetin ekonomik e financiar të vendit.

Nga pikëpamja e ligjshmërisë, projektligji synon të zëvendësojë dhe përditësojë kuadrin ekzistues ligjor për Bankën e Shqipërisë, duke përcaktuar në mënyrë të plotë statusin juridik, objektivat, funksionet, kompetencat, organizimin, qeverisjen, marrëdhëniet me institucionet publike, regjimin financiar, transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë e Bankës. Dispozitat e tij janë hartuar në përputhje me rendin juridik vendas dhe me nevojën për një ligj organik të qartë dhe të qëndrueshëm për bankën qendrore.

Projektligji është në harmoni me legjislacionin vendas në fushën financiare, bankareduke përfshirë kuadrin ligjor për sistemin bankar, sistemet e pagesave, mbikëqyrjen bankare, stabilitetin financiar, administrimin e financave publike, emetimin dhe administrimin e borxhit publik, parandalimin e konfliktit të interesit, auditimin dhe kontrollin financiar, si dhe rregullat për përgjegjësinë administrative dhe gjyqësore. Në rastet kur projektligji parashikon rregulla të posaçme për Bankën e Shqipërisë, këto justifikohen nga natyra e veçantë kushtetuese dhe institucionale e bankës qendrore.

Në aspektin ndërkombëtar dhe evropian, projektligji është hartuar duke pasur parasysh parimet dhe kërkesat e Traktatit për Funksimin e Bashkimit Evropian dhe të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, veçanërisht lidhur me pavarësinë e bankës qendrore, objektivin parësor të stabilitetit të çmimeve, ndalimin e financimit monetar të sektorit publik, ndalimin e aksesit të privilegjuar, ushtrimin e detyrave bazë të bankës qendrore dhe integrimin e ardhshëm në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe në Eurosistem.

Projektligji reflekton parimet e pavarësisë institucionale, funksionale, personale dhe financiare të bankës qendrore, në përputhje me standardet evropiane për bankat qendrore kombëtare. Ai parashikon se Banka e Shqipërisë, organet e saj vendimmarrëse dhe personeli i saj nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga institucionet shtetërore apo nga subjekte të tjera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, ndërsa institucionet dhe subjektet e tjera janë të detyruara të respektojnë këtë pavarësi.

Projektligji është gjithashtu në përputhje me parimin e ndalimit të financimit monetar, duke ndaluar dhënien e kredive, overdrafteve, linjave të kreditit apo formave të tjera të financimit për qeverinë, institucionet shtetërore qendrore ose vendore dhe subjekte të tjera publike, si dhe blerjen direkte në tregun primar të instrumenteve të borxhit të emetuara prej tyre, përveç rasteve të kufizuara të parashikuara shprehimisht në ligj.

Në tërësi, projektligji nuk bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me legjislacionin në fuqi dhe me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë. Përkundrazi, ai synon të forcojë bazën ligjore për funksionimin e Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore e pavarur, të harmonizojë më tej kuadrin vendas me standardet evropiane dhe të krijojë kushtet juridike për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj përafrohet me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e politikës ekonomike dhe monetare, në veçanti me dispozitat përkatëse të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, që lidhen me statusin, objektivat, pavarësinë dhe funksionet e bankave qendrore kombëtare.

Përafrimi lidhet kryesisht me nenin 127 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, i cili përcakton objektivin parësor të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe detyrat bazë të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, përfshirë përcaktimin dhe zbatimin e politikës monetare, kryerjen e operacioneve valutore, mbajtjen dhe administrimin e rezervave zyrtare valutore dhe nxitjen e funksionimit të rregullt të sistemeve të pagesave.

Projektligji reflekton gjithashtu parimet e nenit 130 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe nenit 7 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane për pavarësinë e bankës qendrore, duke sanksionuar ndalimin e kërkimit ose marrjes së udhëzimeve nga institucione, organe apo subjekte të tjera dhe detyrimin e këtyre të fundit për të respektuar pavarësinë e Bankës së Shqipërisë.

Në lidhje me ndalimin e financimit monetar dhe të aksesit të privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare, projektligji përafrohet me nenet 123 dhe 124 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe me nenin 21 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, duke ndaluar financimin e drejtpërdrejtë të qeverisë, institucioneve shtetërore qendrore ose vendore dhe subjekteve të tjera publike nga Banka e Shqipërisë, si dhe blerjen direkte në tregun primar të instrumenteve të borxhit të emetuara prej tyre.

Projektligji merr parasysh edhe dispozitat e Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane që lidhen me objektivat dhe detyrat e SEBQ-së, pavarësinë institucionale, funksionale, personale dhe financiare, operacionet e politikës monetare, administrimin e rezervave valutore, sistemet e pagesave, emetimin e monedhës dhe raportimin financiar, në masën që këto dispozita janë të zbatueshme për një bankë qendrore kombëtare të një shteti kandidat dhe do të bëhen plotësisht të zbatueshme në fazat përkatëse të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe adoptimit të euros.

Në këtë fazë, përafrimi vlerësohet si i pjesshëm, pasi Republika e Shqipërisë nuk është ende shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe Banka e Shqipërisë nuk është ende pjesë e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore apo e Eurosistemit. Për këtë arsye, projektligji parashikon dispozita të posaçme kalimtare dhe të shtyra në kohë, të cilat do të hyjnë në fuqi nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe nga data e adoptimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, projektligji përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit ligjor shqiptar për bankën qendrore me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e politikës ekonomike dhe monetare dhe kontribuon në përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të negociatave për Kapitullin 17 “Politika ekonomike dhe monetare”.

Lista e akteve të Bashkimit Evropian me të cilat përafrohet projektligji:

1. Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, version i konsoliduar, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, C 202, datë 7.6.2016, faqe 47.
2. Protokoll nr. 4 “Për Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane”, bashkëlidhur Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, version i konsoliduar, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, C 202, datë 7.6.2016, faqe 230–250.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kapitulli I – Dispozita të përgjithshme

Kapitulli I përcakton bazat themelore juridike dhe institucionale të Bankës së Shqipërisë si banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Në këtë kapitull sanksionohet statusi i Bankës së Shqipërisë si person juridik publik, me të drejtë të nxjerrë akte normative, të lidhë kontrata dhe të marrë pjesë në procedime gjyqësore, në përputhje me kompetencat që i njihen nga ligji.

Në këtë kapitull përcaktohen gjithashtu selia, simbolet dhe elementet identifikuese të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë të drejtën për të hapur degë, filiale, zyra përfaqësimi ose ambiente operationale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur kjo është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj. Rregullimi i këtyre çështjeve synon të sigurojë qartësi institucionale dhe vazhdimësi në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

Një element i rëndësishëm i këtij kapitulli është përcaktimi i kapitalit të Bankës së Shqipërisë, përbërja e tij dhe rregullat për mbrojtjen e kapitalit të nënshkruar. Parashikohet se kapitali i nënshkruar është plotësisht në pronësi të shtetit shqiptar, është i pa transferueshëm, nuk mund të përdoret si kolateral dhe nuk mund t’i nënshtrohet sekuestrimit. Këto dispozita garantojnë stabilitetin financiar dhe pavarësinë institucionale të bankës qendrore.

Kapitulli 1 përmban gjithashtu dispozitën themelore mbi pavarësinë e Bankës së Shqipërisë. Parashikohet se Banka e Shqipërisë, organet e saj vendimmarrëse dhe personeli i saj nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga institucionet shtetërore apo nga persona të tjerë fizikë ose juridikë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Në të njëjtën kohë, institucionet shtetërore dhe çdo subjekt tjetër detyrohen të respektojnë këtë pavarësi dhe të mos ndikojnë në ushtrimin e funksioneve të Bankës. Ky rregullim është thelbësor për garantimin e një banke qendrore funksionale, të besueshme dhe në përputhje me standardet evropiane për pavarësinë institucionale, funksionale dhe financiare të bankave qendrore.

Kapitulli II – Objektivat, detyrat dhe funksionet e Bankës së Shqipërisë

Kapitulli II përcakton objektivat, detyrat dhe funksionet themelore të Bankës së Shqipërisë, duke qartësuar mandatin e saj institucional dhe rolin e saj në ekonominë kombëtare. Në

përputhje me standardet evropiane, referuar edhe rregullimit aktual të Ligjit Për Bankën e Shqipërisë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë përcaktohet ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ky objektiv konsiderohet si kontributi më i rëndësishëm që banka qendrore mund të japë për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe afatgjatë, dhe ruajtjen e besimit në monedhën kombëtare dhe sistemin financiar shqiptar.

Përtej objektivit kryesor, ky kapitull përcakton objektivat e tjera që lidhen me kontributin e saj në ruajtjen e stabilitetit financiar, mbështetjen e politikave përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit të ndërmarrë nga Qeveria, si dhe shkallën e hierarkisë së tyre. Gjithashtu, ky kapitull sanksionon si parim të përgjithshëm të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë veprimin në përputhje me parimet e një ekonomie të hapur dhe të konkurrencës së lirë, në mbështetje të rritjes së eficiencës së shpërndarjes së burimeve.

Kapitulli II liston detyrat parësore të Bankës së Shqipërisë, në zbatim të objektivave të saj. Këto detyra përfshijnë përcaktimin dhe zbatimin e politikës monetare, përcaktimin dhe zbatimin e regjimit valutor dhe të politikës së kursit të këmbimit, përcaktimin dhe zbatimin e politikës makroprudenciale, licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera të tregut monetar, ushtrimin e funksionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ruajtjen e sigurisë dhe nxitjen e eficiencës së sistemeve të pagesave, administrimin e rezervës valutore, emetimin e monedhës kombëtare, mbështetjen e përkohshme me likuiditet të institucioneve financiare, si dhe hartimin dhe publikimin e statistikave monetare, financiare dhe ato të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Këto funksione paraqesin një qasje moderne ndaj mandatit të bankës qendrore, duke njohur nevojën që stabiliteti monetar dhe ai financiar të trajtohen në mënyrë të koordinuar.

Gjithashtu, Kapitulli II përcakton dhe ato kompetenca me natyrë të përgjithshme të Bankës së Shqipërisë të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrave dhe objektivave të saj.

Kapitulli harmonizon objektivat e Bankës së Shqipërisë me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian dhe me parimet që udhëheqin veprimtarinë e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Në këtë mënyrë sigurohet që kuadri ligjor kombëtar të jetë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian dhe nga roli i ardhshëm i Bankës së Shqipërisë në strukturat e Bashkimit Evropian.

Në tërësi, dispozitat e këtij kapitulli sigurojnë qartësi mbi misionin institucional të Bankës së Shqipërisë dhe kontribuojnë në rritjen e efektivitetit, llogaridhënies dhe transparencës së veprimtarisë së saj.

Kapitulli III – Sistemi i Pagesave

Ky kapitull III përcakton kuadrin e kompetencave të Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemeve të pagesave, me synim garantimin e funksionimit të sigurt, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre. Dispozitat e këtij kapitulli konsolidojnë rolin e Bankës së Shqipërisë në

organizimin, administrimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturave që mbështesin qarkullimin e pagesave dhe shlyerjen e transaksioneve financiare në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë autorizohet të zotërojë, operojë ose të marrë pjesë në sisteme pagesash, si dhe në sisteme të klerimit dhe shlyerjes së titujve. Njëkohësisht, parashikon shprehimisht kompetencën e Bankës së Shqipërisë për të ofruar lehtësi nëpërmjet instrumenteve për pjesëmarrësit në këto sisteme, përfshirë kredinë brenda ditës, në funksion të garantimit të likuiditetit dhe të funksionimit të sigurt e efikas të proceseve të pagesës dhe shlyerjes.

Kapitulli përcakton gjithashtu kompetencën e Bankës së Shqipërisë për të rregulluar dhe mbikëqyrur sistemet e pagesave, si dhe shërbimet dhe instrumentet e pagesave që përbëjnë pjesë integrale të tyre. Kjo dispozitë pasqyron zhvillimet e kuadrit ligjor në fushën e pagesave dhe evoluimin e ekosistemit financiar, ku shërbimet e pagesave ofrohen jo vetëm nga bankat, por edhe nga kategori të tjera institucioneve financiare. Në këtë kuadër, synohet garantimi i sigurisë, integritetit dhe efikasitetit të proceseve të pagesave, si dhe mbështetja e stabilitetit financiar në vend.

Për më tepër, në funksion të mbikëqyrjes së infrastrukturave të tregut financiar me rëndësi sistematike, kapitulli parashikon bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, duke krijuar hapësirat e nevojshme ligjore për koordinimin e veprimtarisë së dy autoriteteve në ushtrimin e funksioneve të tyre përkatëse. Më konkretisht ky parashikim harmonizon legjislacionin për sistemet e pagesave me legjislacionin organik të Bankës së Shqipërisë duke konsoliduar më tej bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për stabilitetin financiar dhe harmonizohet me standardet bashkëkohore të mbikëqyrjes së infrastrukturave financiare.

Në tërësi, ky kapitull krijon bazën ligjore për funksionimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe të infrastrukturave të tregut financiar, duke mbështetur zhvillimin e tregut financiar, rritjen e sigurisë së transaksioneve dhe forcimin e stabilitetit financiar në vend.

Kapitulli IV – Operacionet monetare dhe të tjera

Kapitulli IV rregullon kuadrin ligjor për formulimin dhe zbatimin e politikës monetare nga Banka e Shqipërisë. Politika monetare përbën një nga funksionet themelore të bankës qendrore dhe është instrumenti kryesor nëpërmjet të cilit realizohet objektivi i stabilitetit të çmimeve.

Dispozitat e këtij kapitulli i japin Bankës së Shqipërisë kompetencat e nevojshme për të përcaktuar, miratuar dhe zbatuar politikën monetare, duke përdorur një gamë të gjerë instrumentesh të njohura ndërkombëtarisht. Në këtë kuadër parashikohen operacionet e tregut të hapur, operacionet e kreditimit dhe depozitimit, rezerva e detyrueshme dhe instrumente të tjera që mund të përdoren për të ndikuar në kushtet monetare dhe financiare të ekonomisë.

Gjithashtu, në mbështetje të stabilitetit financiar, ky kapitull parashikon të drejtën e përdorimit të instrumentit të mbështetjes me likuiditet për institucione krediti të cilat vlerësohen të kenë

rëndësi sistematike, si dhe për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave (ASD), duke përcaktuar njëkohësisht kompetencat vendimmarrëse, kriteret dhe limitet e përdorimit të këtij instrumenti

Kapitulli synon t'i sigurojë Bankës së Shqipërisë fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur zhvillimeve ekonomike, financiare dhe monetare, duke shmangur kufizimet e panevojshme ligjore që mund të pengojnë efektivitetin e politikës monetare. Në të njëjtën kohë, parashikohen garanci të mjaftueshme për transparencën dhe përgjegjshmërinë e procesit vendimmarrës.

Një aspekt i rëndësishëm i këtyre dispozitave është përafrimi me kuadrin operativ të bankave qendrore të Bashkimit Evropian. Instrumentet dhe mekanizmat e parashikuar janë konceptuar në mënyrë të tillë që të jenë të pajtueshme me standardet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të lehtësojnë integrimin gradual të Bankës së Shqipërisë në strukturat monetare evropiane.

Nëpërmjet këtij kapitulli krijohet një bazë e fortë juridike për ushtrimin efektiv të politikës monetare dhe për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik e financiar të vendit.

Kapitulli V – Këmbimet valutore

Kapitulli V rregullon kuadrin ligjor për këmbimet valutore dhe administrimin e rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë. Në përputhje me objektivin parësor të Bankës dhe me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, ky kapitull përcakton kompetencat e Bankës për llogaritjen dhe publikimin e kursit zyrtar të këmbimit të monedhave të huaja kundrejt lekut, kryerjen e pagesave ndërkombëtare në kuadër të funksioneve të saj si bankë qendrore, si dhe realizimin e operacioneve valutore në përputhje me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse.

Kapitulli trajton gjithashtu autoritetin e Bankës së Shqipërisë për mbajtjen dhe administrimin e rezervave valutore, me qëllim mbështetjen e zbatimit të politikës monetare, të politikës së kursit të këmbimit dhe të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit. Administrimi i rezervës valutore kryhet mbi bazën e parimeve të likuiditetit dhe sigurisë së investimit, ndërsa kriteret të tjera mund të merren në konsideratë vetëm në masën që nuk cenojnë këto parime themelore, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Neni 15 i projektligjit i kushtohet rezervave valutore që mbahen dhe administrohen nga Banka e Shqipërisë. Ky nen përcakton qëllimet për të cilat Banka mban rezerva valutore, si instrument thelbësor për përmbushjen e funksioneve të saj kryesore, përfshirë zbatimin e politikës monetare, politikës së kursit të këmbimit dhe mbështetjen e stabilitetit financiar. Ky rregullim siguron qartësi dhe transparencë mbi përdorimin e rezervave valutore dhe është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare të administrimit të rezervave nga bankat qendrore.

Kapitulli VI – Monedha

Kapitulli VI rregullon kuadrin juridik që lidhet me emetimin, qarkullimin dhe mbrojtjen e monedhës kombëtare. Nëpërmjet këtij kapitulli riafirmohet e drejta ekskluzive e Bankës së Shqipërisë për emetimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike, si atribut themelor i sovranitetit monetar të shtetit.

Dispozitat përcaktojnë procedurat dhe kompetencat për prodhimin, hedhjen në qarkullim, tërheqjen nga qarkullimi dhe asgjësimin e kartëmonedhave dhe monedhave, si dhe statusin e tyre si mjet ligjor pagese në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, rregullohen çështje që lidhen me shkëmbimin e monedhës, trajtimin e kartëmonedhave të dëmtuara dhe masat për mbrojtjen e integritetit të parasë.

Një rëndësi të veçantë kanë dispozitat që lidhen me luftën kundër falsifikimit dhe kundërveprimeve të tjera që mund të cenojnë besimin e publikut tek monedha kombëtare. Në këtë kuadër, Bankës së Shqipërisë i njihen kompetenca të posaçme për verifikimin, identifikimin dhe trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara, si dhe për bashkëpunimin me autoritetet përkatëse brenda dhe jashtë vendit.

Kapitulli VII – Stabiliteti financiar

Kapitulli VII përbën një nga risitë e projektligjit, pasi zbërthen në mënyrë të posaçme rolin e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar. Në këtë kapitull konsolidohen qëllimisht dimensionin mikroprudencial (i mbikëqyrjes në nivel institucioni) dhe ai makroprudencial (i mbikëqyrjes në nivel sistemi) të mandatit të Bankës së Shqipërisë, të cilët janë plotësues dhe nuk mund të ndiqen të shkëputur nga njëri-tjetri.

Në këtë kapitull përcaktohen kompetencat kryesore që Banka ushtron në lidhur me rregullimin, licencimin dhe mbikëqyrjen prudenciale të subjekteve të sistemit financiar.

Sipas parashikimeve në këtë kapitull, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë masa administrative ndaj subjekteve të mbikëqyrura, të kryejë inspektime në vend përmes punonjësve të saj ose ekspertëve të autorizuar, duke shqyrtuar llogaritë, regjistrat, dokumentacionin dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, si dhe të kërkojë nga institucionet e mbikëqyrura çdo informacion apo dokumentacion që lidhet me veprimtarinë, gjendjen financiare dhe menaxhimin e rrezikut, të cilin këto institucione kanë detyrimin ligjor ta vënë në dispozicion.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka kompetencën të publikojë informacion dhe të dhëna në përputhje me kërkesat e konfidencialitetit, duke bërë publike vetëm të dhëna të agreguara ose në rastet e parashikuara nga ligji, si dhe të zbatojë masa makroprudenciale për kufizimin dhe zbutjen e rrezikut sistematik, në përputhje me parashikimet në këtë ligj.

Në kuadër të mbikëqyrjes mikroprudenciale sipas nenit 25, kompetenca për vendosjen e masave administrative i mundëson Bankës së Shqipërisë të kërkojë, në mënyrë graduale, proporcionale dhe në përputhje me një proces të rregullt ligjor, korrigjimin e praktikave të pasigurta ose jo të shëndosha si dhe të çdo shkelje të kërkesave prudenciale.

Kompetenca për të kryer inspekte në vend, përfshin të drejtën për të shqyrtuar llogaritë, librat, dokumentet dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm nëpërmjet personelit të Bankës së Shqipërisë dhe personave të tjerë të kualifikuar e të autorizuar. Kjo është e domosdoshme për të verifikuar gjendjen financiare të subjekteve të mbikëqyrura dhe kuadrin e tyre të administrimit të rrezikut.

Detyrimi i subjekteve të mbikëqyrura për të dhënë çdo informacion dhe dokumentacion përkatës, përfshirë lidhur me veprimtaritë, gjendjen financiare dhe administrimin e rrezikut të tyre, siguron që mbikëqyrja të mbështetet në të dhëna të plota dhe të përditësuara, si edhe mundëson identifikimin e hershëm të rreziqeve.

Kompetenca për të publikuar informacione dhe të dhëna i shërben disiplinës së tregut dhe transparencës, që kontribuojnë në stabilitetin financiar. Megjithatë, ky publikim kryhet vetëm në formë të agreguar, ose ndryshe në përputhje me regjimin e sekretit profesional të parashikuar në nenin 68. Kjo mbron konfidencialitetin e subjekteve individuale dhe përputhet me detyrimet e sekretit profesional jo vetëm sipas legjislacionit shqiptar por edhe atij evropian të fushës.

Ndërsa, kompetenca për të zbatuar masat makroprudenciale për kufizimin e rrezikut sistemik, në përputhje me nenin 26, e lidh mbikëqyrjen specifike të institucionit sipas nenit 25 të projektligjit, me objektivin makroprudencial, duke siguruar që masat drejtuar institucioneve individuale të kalibrohen duke konsideruar edhe rrezikun në nivel sistemi dhe që të dyja funksionet të veprojnë në mënyrë koherente e jo në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Neni 26 i jep Bankës së Shqipërisë një mandat të qartë makroprudencial. Për të mbrojtur stabilitetin e sistemit financiar, Banka vlerëson zhvillimet e rrezikut sistemik, i kuptuar si rreziku i një ndërprerjeje në aktivitetin e sistemit financiar që mund të sjellë pasoja serioze negative për ekonominë reale, dhe merr masa për ta kufizuar atë. Kjo është në përputhje me Rekomandimin ESRB/2011/3 për mandatin makroprudencial të autoriteteve kombëtare.

Masat makroprudenciale janë kryesisht të natyrës prudenciale dhe ndjekin tre synime plotësuese: të rrisin qëndrueshmërinë e sistemit financiar ndaj goditjeve agregate; të kontrollojnë akumulimin e rreziqeve sistematike përgjatë kohës (dimensioni ciklik); dhe të kontrollojnë rreziqet strukturore brenda sistemit financiar (dimensioni ndërsektorial).

Zbatimi i politikës makroprudenciale varet nga monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të rrezikut sistemik dhe nga aksesimi në të dhëna të hollësishme, të cilat Banka e Shqipërisë i siguron nëpërmjet funksionit të saj mbikëqyrës (neni 25) dhe funksionit të saj statistikor. Ky vlerësim mbështet aktivizimin, ri kalibrimin dhe çlirimin proporcional dhe në kohë të instrumenteve makroprudenciale, në mënyrë që masat të shtrëngohen ndërsa rreziqet akumulohen dhe të lehtësohen kur ato zbehen.

Për të vlerësuar rrezikun sistemik dhe për të zbatuar masat makroprudenciale, Banka e Shqipërisë duhet të bashkëpunojë me autoritetet e tjera vendase, përfshirë autoritetin përgjegjës

për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) dhe ministrinë përgjegjëse për financat, në mënyrë që rreziqet që përfshijnë sektorin bankar dhe atë jobankar të trajtohen në mënyrë koherente dhe që perimetri i politikës makroprudenciale të mos fragmentarizohet. Paralelisht, duke konsideruar natyrën ndërkufitare të veprimtarisë financiare, ky bashkëpunim nevojitet edhe me autoritetet përkatëse të vendeve të origjinës apo ato pritëse, të subjekteve të mbikëqyrura, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit apo njohjes dhe reciprocitetit të masave respektive. Ky proces bashkëpunimi është i nevojshëm për të shmangur rastet e anashkalimit të kërkesave rregullatore dhe mbikëqyrëse, dhe për të siguruar efektivitetin e masave.

Kreu VII është hartuar për të mbetur funksional si para, ashtu edhe pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian: ai i jep efekt paraprakisht nenit 127(5) të TFBE-së dhe do të ushtrohet, pas anëtarësimit, brenda Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes Financiare dhe në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane — përfshirë, sipas rastit, bashkëpunimin e ngushtë sipas Mekanizmit të Vetëm të Mbikëqyrjes (SSM) — me Autoritetet Evropiane të Mbikëqyrjes dhe me Bordin Evropian të Rrezikut Sistemik.

Kapitulli VIII – Statistikat dhe sistemi raportues

Projektligji përforcon bazën ligjore të funksionit statistikor të Bankës së Shqipërisë, duke e përcaktuar hartimin, administrimin dhe publikimin e statistikave si një nga funksionet e rëndësishme të saj, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe *acquis* të Bashkimit Evropian.

Për këtë qëllim, projektligji përfshin një kapitull të veçantë mbi sistemin e raportimit dhe statistikave, i cili rregullon në mënyrë të plotë kompetencat e Bankës së Shqipërisë për organizimin e sistemit të raportimit statistikor, përcaktimin e subjekteve raportuese, kërkesave për raportim dhe mbledhjen e informacionit statistikor të nevojshëm për përmbushjen e funksioneve të saj dhe të detyrimeve ndaj institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, dispozitat e këtij kapitulli përcaktojnë rregullat për shkëmbimin e informacionit statistikor me autoritetet publike, INSTAT-in, bankat qendrore dhe organizatat ndërkombëtare, duke garantuar mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit statistikor dhe përdorimin e tij vetëm për qëllime statistikore. Njëkohësisht, ato forcojnë transparencën përmes publikimit të statistikave, metodologjive dhe metadatave, në përputhje me parimet ndërkombëtare të cilësisë statistikore.

Këto dispozita harmonizojnë kuadrin ligjor të Bankës së Shqipërisë me nenin 5 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, si dhe me Rregulloren (EC) Nr. 2533/98 të Këshillit mbi mbledhjen e informacionit statistikor nga Banka Qendrore Evropiane, duke forcuar bazën ligjore për përmbushjen e detyrimeve statistikore të Bankës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit Evropian dhe pjesëmarrjes së ardhshme në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Kapitulli IX – Marrëdhëniet me Qeverinë dhe subjektet e tjera publike

Kapitulli IX rregullon marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Qeverisë dhe subjekteve të tjera publike, duke ruajtur një balancë të qartë ndërmjet bashkëpunimit institucional dhe pavarësisë së bankës qendrore.

Në këtë kapitull përcaktohet roli i Bankës së Shqipërisë si agjent fiskal i qeverisë. Banka mund të kryejë veprime që lidhen me emetimin e letrave me vlerë të qeverisë, regjistrimin e tyre, organizimin e ankandeve, shlyerjen e principalit dhe interesave, si dhe veprime të tjera ndihmëse, në bazë të marrëveshjes përkatëse me ministrin përgjegjës për financat. Ky funksion ushtrohet duke respektuar në çdo rast ndalimin e financimit monetar.

Projektligji parashikon gjithashtu mundësinë që Banka e Shqipërisë të veprojë si bankier për qeverinë dhe institucionet financiare qeveritare, duke hapur dhe mbajtur llogari për to, si dhe duke kryer pagesa vetëm brenda kufijve të fondeve të disponueshme në këto llogari. Kjo garanton që Banka të ofrojë shërbime bankare për sektorin publik, pa krijuar mekanizma financimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të qeverisë.

Kapitulli forcon bashkëpunimin institucional dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike për çështje me interes të përbashkët, si zhvillimet monetare, fiskale, makroekonomike dhe të sistemit financiar. Ky bashkëpunim kryhet pa cenuar pavarësinë dhe autonominë e Bankës së Shqipërisë.

Kapitulli parashikon edhe detyrimin për institucionet qendrore, (Qeveri dhe Kuvend) që Banka e Shqipërisë të konsultohet për projektakte ligjore ose normative që lidhen me objektivat dhe detyrat e saj. Kjo dispozitë synon të garantojë që qëndrimi profesional i Bankës të merret në konsideratë në procesin ligjvënës dhe rregullator për çështjet që prekin funksionet e bankës qendrore.

Një nga elementet më të rëndësishme të kapitullit është ndalimi i financimit monetar të sektorit publik. Banka e Shqipërisë nuk mund të japë kredi, overdraft, linja kredie apo forma të tjera financimi për qeverinë, institucionet shtetërore qendrore ose vendore dhe subjekte të tjera publike. Gjithashtu, ajo nuk mund të blejë në tregun primar instrumente borxhi të emetuara nga këto subjekte, përveç rasteve të kufizuara të parashikuara shprehimisht në nenin 35 të projektligjit. Ky ndalim është në përputhje me parimet evropiane për shmangien e financimit monetar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të sektorit publik dhe për ruajtjen e disiplinës fiskale. Deri në momentin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në BE, Banka e Shqipërisë do të vijojë të blejë në tregun primar vetëm për qëllime të administrimit të strukturës së bilancit të saj, në kuadër të riinvestimit të fondeve që rrjedhin nga maturimi i titujve ekzistues të mbajtur prej saj, në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligj.

Kapitulli X – Organizimi dhe qeverisja

Kapitulli X vendos kuadrin ligjor të organizimit dhe qeverisjes së Bankës së Shqipërisë, duke përcaktuar organet drejtuese, ndarjen e kompetencave, kriteret e emërimit, mbrojtjen e mandatit, papajtueshmëritë, konfliktin e interesit dhe procedurat e vendimmarrjes. Këto rregullime janë thelbësore për ushtrimin efektiv të mandatit të Bankës, për ruajtjen e pavarësisë së saj dhe për sigurimin e përgjegjshmërisë publike pa ndërhyrje në vendimmarrjen profesionale.

Kapitulli reflekton kërkesat e *acquis* për pavarësinë institucionale, funksionale, personale dhe financiare të bankave qendrore kombëtare. Në përputhje me nenin 130 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, nenin 7 të Statutit të SEBQ/BQE-së dhe nenin 4 të projektligjit, Banka e Shqipërisë, organet e saj vendimmarrëse dhe personeli i saj nuk duhet të kërkojnë ose marrin udhëzime nga institucione apo subjekte të tjera, ndërsa këto të fundit duhet të respektojnë pavarësinë e Bankës. Neni 131 i TFBE-së shërben si referencë plotësuese për detyrimin që legjislacioni kombëtar të jetë në përputhje me Traktatet dhe Statutin e SEBQ/BQE-së.

Sipas nenit 36 të projektligjit, Banka qeveriset nga Këshilli dhe administrohet nga Guvernatori dhe dy Zëvendësguvernatorët. Këshilli, si organ kolegjal, formulon politikat, miraton vendimet strategjike dhe ushtron mbikëqyrje institucionale, ndërsa Guvernatori, në përputhje me nenin 40, drejton veprimtarinë e përditshme dhe zbaton politikat e vendimet e Këshillit. Kjo ndarje siguron dallim të qartë ndërmjet funksioneve politikëbërëse, mbikëqyrëse dhe ekzekutive.

Projektligji ruan vazhdimësinë institucionale në lidhje me përbërjen e Këshillit, duke mbajtur të pandryshuar numrin e anëtarëve, si dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre, në përputhje me zgjidhjen e parashikuar edhe në ligjin ekzistues. Në këtë mënyrë, reforma nuk synon ndryshimin e arkitekturës bazë të organit më të lartë drejtues të Bankës së Shqipërisë, por forcimin dhe qartësimin e garancive që lidhen me mënyrën e emërimit, kriteret profesionale dhe të integritetit, mbrojtjen e mandatit, papajtueshmëritë, konfliktin e interesit dhe procedurat e vendimmarrjes. Këto risi synojnë të konsolidojnë cilësinë, qëndrueshmërinë dhe pavarësinë e qeverisjes së Bankës, pa cenuar modelin institucional të provuar në kuadrin ligjor ekzistues.

Kompetencat e Këshillit, të parashikuara në nenin 37, përfshijnë politikat kryesore të Bankës, instrumentet monetare, rezervën e detyrueshme, kursin e këmbimit, rregullimin dhe mbikëqyrjen bankare, stabilitetin financiar dhe makroprudencial, administrimin e rezervës valutore, buxhetin, pasqyrat financiare, auditimin, strukturën organizative dhe aktet e brendshme normative. Kjo e vendos Këshillin si organin kryesor të qeverisjes, në përputhje me nenin 127 të TFBE-së dhe nenet 2, 3, 12.1, 18 dhe 19 të Statutit të SEBQ/BQE-së, që përcaktojnë objektivat, detyrat dhe instrumentet bazë të bankës qendrore.

Rregullat për emërimin dhe përbërjen e Këshillit, sipas neneve 41 dhe 42, synojnë të garantojnë kapacitet profesional, integritet dhe ekspertizë të përshtatshme në ekonomi, financë, banking, menaxhim rreziku, çështje ligjore dhe auditim. Kriteret e integritetit, reputacionit, përvojës dhe

arsimit të lartë, së bashku me papajtueshmëritë dhe konfliktin e interesit të parashikuara në nenet 43 dhe 63, shërbejnë si garanci kundër ndikimeve politike, tregtare ose institucionale që mund të cenojnë paanshmërinë e vendimmarrjes.

Garancitë për kohëzgjatjen e mandatit, mbarimin, dorëheqjen dhe shkarkimin, të parashikuara në nenet 41, 44, 45 dhe 46, janë elemente thelbësore të pavarësisë personale. Në përputhje me nenin 14.2 të Statutit të SEBQ/BQE-së, largimi nga detyra duhet të jetë i mundur vetëm mbi baza objektive dhe të përcaktuara në ligj, jo për arsye që lidhen me përmbajtjen e vendimmarrjes profesionale. Garancitë procedurale, arsyetimi i vendimit dhe kontrolli gjyqësor mbrojnë anëtarët e organeve drejtuese nga shkarkimi arbitrar dhe presionet e jashtme.

Nenet 48 dhe 49 përcaktojnë rregullat për mbledhjet, kuorumin, shumicat, pjesëmarrjen në distancë, procedurën e shkruar, përjashtimin nga votimi në rast konflikti interesi dhe konfidencialitetin e dokumentacionit. Këto dispozita sigurojnë vendimmarrje kolegjiale, të dokumentuar dhe juridikisht të qëndrueshme, duke mbrojtur njëkohësisht informacionin e ndjeshëm në përputhje me regjimin e sekretit profesional të trajtuar nga neni 68.

Komiteti i Politikës Monetare dhe Komiteti i Stabilitetit Financiar, të parashikuara në nenet 38 dhe 39, mbështesin Këshillin dhe Guvernatorin me analizë dhe këshillim teknik.

Pavarësia e Bankës nuk përjashton llogaridhënien. Për këtë arsye, kapitulli duhet lexuar së bashku me dispozitat për raportimin, auditimin dhe transparencën, veçanërisht nenet 56–60. Këto mekanizma shërbejnë për kontroll demokratik dhe verifikim ex post, pa u shndërruar në mjete udhëzimi, miratimi paraprak ose kontrolli të përmbajtjes së politikave të Bankës, në përputhje me qasjen e raporteve të konvergjencës së BQE-së.

Në tërësi, Kapitulli X krijon një kuadër qeverisjeje të pajtueshëm me kërkesat e konvergjencës ligjore dhe me standardet ndërkombëtare për autonominë dhe përgjegjshmërinë e bankave qendrore. Ai përcakton qartë organet dhe kompetencat, forcon garancitë kundër ndikimeve të jashtme dhe krijon bazën për përmbushjen graduale të detyrimeve që rrjedhin nga nenet 127, 130 dhe 131 të TFBE-së, nenet 2, 3, 7 dhe 14.2 të Statutit të SEBQ/BQE-së, si dhe nga integrimi i ardhshëm në SEBQ dhe Eurosistem.

Kapitulli XI – Personeli i Bankës së Shqipërisë

Kapitulli XI rregullon statusin e personelit të Bankës së Shqipërisë dhe marrëdhëniet e punës brenda institucionit. Projektligji përcakton se marrëdhëniet e punës së personelit të Bankës rregullohen nga ky ligj, Kodi i Punës dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli, dhe nuk i nënshtrohen legjislacionit për nëpunësin civil.

Ky rregullim pasqyron natyrën e veçantë të Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore dhe institucion i pavarur, i cili duhet të ketë fleksibilitetin e nevojshëm për të rekrutuar, mbajtur dhe zhvilluar personel me kualifikim të lartë profesional në fusha të specializuara, si politika monetare, stabiliteti financiar, mbikëqyrja bankare, statistikë, sistemet e pagesave, administrimi i rezervës valutore, teknologjia dhe çështjet ligjore.

Projektligji përcakton se, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, Guvernatori vepron si punëdhënës i personelit të Bankës, duke ushtruar kompetencat për emërimin, promovimin, vlerësimin, masat disiplinore dhe largimin nga puna. Në të njëjtën kohë, marrëdhëniet e punës bazohen në parimet e meritokracisë, profesionalizmit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

Kapitulli synon të garantojë që administrimi i burimeve njerëzore në Bankën e Shqipërisë të jetë i përshtatur me standardet dhe nevojat e një institucioni të pavarur financiar, duke ruajtur njëkohësisht integritetin, përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e personelit.

Kapitulli XII – Dispozitat financiare

Kapitulli XII rregullon përkufizimin dhe trajtimin e llogarive rezervë, trajtimin e fitimit e humbjes të Bankës, si dhe mekanizmat dhe burimin e rikapitalizimit në rastet e mungesës së mjeteve apo rënies së kapitalit nën nivelet minimale të përcaktuara në Kreun 1. Projektligji përcakton një mekanizëm të qartë, sipas të cilit, nëse kapitali i bankës rezulton nën nivelin e kapitalit të nënshkruar, nuk kryhet shpërndarje fitimi dhe Qeveria detyrohet të transferojë mjete monetare apo tituj të tregtueshëm për rikthimin e kapitalit në nivelin minimal të përcaktuar me ligj. Bazuar edhe në rekomandimet e FMN, draft ligji përcakton nivelin minimal të kapitalit.

Ligji aktual përcakton elementë që zbriten nga të ardhurat për llogaritjen e fitimit neto. Dispozitat e projektligjit në këtë kre, thjeshtojnë trajtimin e fitimit ose humbjes vjetore, duke përcaktuar se ai llogaritet si diferencë ndërmjet të ardhurave totale dhe shpenzimeve totale të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu sipas parashikimeve të projektligjit të propozuar, Banka e Shqipërisë ruan të drejtën mbi përdorimin dhe shpërndarjen e fitimit të saj. Në këtë kuadër, ajo ka autonominë për të vendosur mbi destinimin e fitimit, duke i orientuar ato drejt forcimit të pozicionit financiar të saj. Në projektligj parashikohet që, Banka mund të rrisë rezervat e saj me qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e kapitalit.

Lidhur me Rezervën e Përgjithshme, projekti i propozuar ruan raportin minimal aktual prej 500% të Kapitalit të nënshkruar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi, si dhe përcakton qartë përdorimin e rezervës së përgjithshme vetëm për mbulimin e humbjeve ose rritjen e kapitalit të nënshkruar. Për më tepër, është parashikuar krijimi i llogarive të rivlerësimit dhe i rezervave të posaçme për rreziqe financiare apo nevoja të tjera të veçanta.

Dispozitat e kreut lidhur me rezervën e rivlerësimit, parashikojnë një trajtim më të qartë të efekteve që rrjedhin nga kurset e këmbimit dhe vlerës së tregut e në veçanti adreson drejtpërdrejt rolin e qeverisë në situatat kur këto efekte ndikojnë negativisht në kapitalin e Bankës së Shqipërisë, duke garantuar stabilitet financiar dhe mbrojtje më efektive të Kapitalit të Bankës.

Kapitulli XII trajton kuadrin e raportimit institucional, kontabilitetit, auditimit dhe përgjegjshmërisë së Bankës së Shqipërisë. Dispozitat e këtij kapitulli mbështeten në parimin sipas të cilit pavarësia e bankës qendrore duhet të shoqërohet me mekanizma të qartë

transparence dhe llogaridhënieje ndaj institucioneve demokratike dhe publikut. Në këtë kuptim, kapitulli synon të krijojë një balancë të qëndrueshme ndërmjet autonomisë së Bankës së Shqipërisë në ushtrimin e mandatit të saj dhe përgjegjësisë për të raportuar mbi mënyrën e realizimit të objektivave dhe funksioneve të saj.

Dispozitat e kapitullit përcaktojnë standardet që Banka e Shqipërisë duhet të zbatojë në mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe administrimin e informacionit financiar. Nëpërmjet këtyre dispozitave sigurohet që veprimtaria financiare e Bankës të dokumentohet dhe të raportohet në përputhje me standarde profesionale të njohura ndërkombëtarisht, duke garantuar saktësinë, besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e informacionit financiar.

Një element me rëndësi të veçantë i këtij kapitulli është rregullimi i procesit të auditimit. Projektligji parashikon mekanizma të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm që synojnë të garantojnë përdorimin e kujdesshëm të burimeve financiare të Bankës, respektimin e kuadrit ligjor dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në veçanti, auditimi i jashtëm përbën një instrument të rëndësishëm për verifikimin e pasqyrave financiare dhe për forcimin e besimit të publikut dhe institucioneve shtetërore në integritetin financiar të Bankës së Shqipërisë.

Kapitulli trajton gjithashtu rolin e auditimit të brendshëm si një mekanizëm i pavarur që kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të administrimit, kontrollit dhe menaxhimit të rrezikut. Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare të qeverisjes institucionale, funksioni i auditimit të brendshëm konsiderohet një element thelbësor për garantimin e efikasitetit operacional dhe mbrojtjen e integritetit institucional të bankës qendrore.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i këtij kapitulli lidhet me përgjegjshmërinë institucionale të Bankës së Shqipërisë ndaj Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se Banka gëzon një nivel të lartë pavarësie në ushtrimin e funksioneve të saj, është e nevojshme që kjo pavarësi të shoqërohet me detyrimin për të raportuar periodikisht mbi zbatimin e politikave dhe realizimin e objektivave të saj. Përmes raporteve, paraqitjeve publike dhe mekanizmave të tjerë të llogaridhënies, Kuvendi dhe publiku informohen mbi veprimtarinë, vendimmarrjen dhe rezultatet e Bankës së Shqipërisë.

Dispozitat e kapitullit kontribuojnë gjithashtu në rritjen e transparencës së politikës monetare dhe të politikave të tjera që ushtrohen nga Banka e Shqipërisë. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se efektiviteti i bankave qendrore nuk varet vetëm nga cilësia e vendimmarrjes, por edhe nga niveli i besimit të publikut dhe tregjeve financiare. Për këtë arsye, publikimi i informacionit, raportimi periodik dhe komunikimi institucional konsiderohen elementë thelbësorë të mandatit të bankës qendrore moderne.

Përmbajtja e Kapitullit XII është hartuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të bankave qendrore të Bashkimit Evropian dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, ku

pavarësia institucionale shoqërohet gjithmonë me mekanizma të fortë transparence dhe përgjegjshmërie. Në këtë mënyrë, projektligji siguron që Banka e Shqipërisë të disponojë një kuadër të plotë raportimi dhe kontrolli, i cili rrit besueshmërinë e institucionit, forcon legjitimitetin e tij publik dhe garanton administrimin e kujdesshëm të funksioneve dhe burimeve që i janë besuar me ligj.

Në tërësi, Kapitulli XII konsolidon bazën ligjore për transparencën, kontrollin financiar dhe përgjegjshmërinë institucionale të Bankës së Shqipërisë, duke krijuar garanci të rëndësishme për Kuvendin, institucionet shtetërore, tregjet financiare dhe publikun se funksionet e bankës qendrore ushtrohen në mënyrë profesionale, të pavarur dhe në interes të stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

Kapitulli XIII – Dispozita të përgjithshme

Kapitulli XIII përmban rregulla të përgjithshme që mbështesin funksionimin efektiv të Bankës së Shqipërisë dhe ushtrimin e kompetencave të saj. Këto dispozita lidhen me aktet ligjore dhe normative të Bankës, masat administrative dhe sanksionet, konfliktin e interesit, tarifat dhe komisionet, aktivitetet e ndaluara, përjashtimet tatimore, përparësinë e këtij ligji ndaj ligjeve të tjera, sekretin profesional, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, të drejtën preferenciale, kontrollin gjyqësor, përgjegjësinë, imunitetet dhe mbrojtjen e funksioneve institucionale.

Në këtë kapitull parashikohet e drejta e Bankës së Shqipërisë për të nxjerrë akte normative dhe akte të tjera të nevojshme për ushtrimin e detyrave të saj. Aktet normative hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa aktet individuale pas njoftimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe. Ky rregullim garanton bazën ligjore për veprimtarinë rregullatore dhe administrative të Bankës.

Projektligji i njeh Bankës së Shqipërisë kompetencën për të vendosur masa administrative dhe sanksione ndaj personave fizikë ose juridikë që shkelin këtë ligj, aktet normative të nxjerra në zbatim të tij ose ligje të tjera për të cilat Banka ka juridiksion. Masat parashikohen të jenë proporcionale, efektive dhe parandaluese, duke marrë parasysh natyrën, rëndësinë, kohëzgjatjen dhe përsëritjen e shkeljes.

Një pjesë e rëndësishme i kushtohet konfliktit të interesit, etikës dhe integritetit, trajtuar kjo në përputhje me legjislacionin e brendshëm të fushës. Anëtarët e Këshillit, personeli i Bankës dhe çdo person që vepron në emër të saj duhet të ushtrojnë funksionet me paanshmëri dhe integritet, të parandalojnë dhe deklarojnë konfliktet e interesit dhe të respektojnë rregullat për dhuratat, përfitimet dhe periodhat e kufizimit pas përfundimit të funksionit. Këto dispozita forcojnë besueshmërinë institucionale dhe parandalojnë ndikimet e papërshtatshme në vendimmarrje.

Kapitulli parashikon gjithashtu, ashtu si edhe legjislacioni i brendshëm, ndalimin e disa praktikave që nuk janë në përputhje me natyrën e bankës qendrore, si dhënia e ndihmës financiare, dhurimeve, kredive të drejtpërdrejta, subvencionimi i detyrimeve ose përfshirja në

veprimtari tregtare, përveç rasteve të autorizuar shprehimisht nga ligji. Kjo synon të ruajë fokusin e Bankës në funksionet e saj publike dhe të shmangë rreziqe të papërshtatshme financiare apo reputacionale.

Dispozitat për sekretin profesional dhe konfidencialitetin janë të detajuara dhe përcaktojnë qartë se çfarë përbën për Bankën e Shqipërisë informacion konfidencial, cilët persona janë të detyruar ta ruajnë atë, rastet kur mund të bëhet zbulimi i informacionit dhe kushtet për shkëmbimin e tij me autoritete vendase, të huaja dhe ndërkombëtare. Këto rregulla janë veçanërisht të rëndësishme për mbikëqyrjen bankare, stabilitetin financiar, statistikën, shkëmbimin ndërinstitucional të informacionit dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare. Dispozitat që rregullojnë konfidencialitetin, janë hartuar mbështetur në praktikën më të mirë që rregullojnë transparencën dhe konfidencialitetin e Bankave Qendrore si dhe të praktikave Evropiane.

Kapitulli përmban edhe dispozita mbi të drejtën preferenciale të Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e pretendimeve të saj ndaj debitorëve, imunitetin e pasurisë, rezervave valutore dhe transaksioneve të saj, si dhe kufizimet e nevojshme mbi masat mbrojtëse ose ekzekutive ndaj pasurisë së Bankës. Këto parashikime synojnë të mbrojnë aftësinë e Bankës për të ushtruar pa ndërprerje funksionet e saj ligjore, veçanërisht në fushën e politikës monetare, stabilitetit financiar dhe administrimit të rezervës valutore.

Në këtë kapitull parashikohen gjithashtu rregulla për kontrollin gjyqësor dhe përgjegjësinë dhe mbrojtjen ligjore, duke përcaktuar se shqyrtimi gjyqësor kufizohet në ligjshmërinë e veprimeve ose mosveprimeve të Bankës, pa cenuar diskrecionin profesional dhe politikëbërës të bankës qendrore. Anëtarët e Këshillit, personeli dhe personat e autorizuar nga Banka nuk mbajnë përgjegjësi për veprime ose mosveprime të kryera gjatë përmbushjes së rregullt në ushtrimin e detyrave, përveç rasteve të paligjshmërive të qëllimshme ose pakujdesisë së rëndë. Ky rregullim është i nevojshëm për të mbrojtur vendimmarrjen profesionale të Bankës në fusha komplekse dhe me ndikim sistemik.

Kapitulli XIV – Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Kapitulli XIV përmban dispozita që do të zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Qëllimi i këtij kapitulli është të sigurojë përafrimin e statusit, objektivave dhe funksioneve të Bankës së Shqipërisë me kuadrin juridik të Bashkimit Evropian dhe me rregullat që zbatohen për bankat qendrore kombëtare si pjesë e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Në këtë kapitull parashikohet se Banka e Shqipërisë do të bëhet pjesë përbërëse e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe do të ushtrojë funksionet e saj në përputhje me Traktatin për Bashkimin Evropian, Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, aktet e zbatueshme drejtpërdrejt të Bashkimit Evropian dhe dispozitat e këtij ligji.

Kapitulli sanksionon pavarësinë e Bankës së Shqipërisë brenda Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, në përputhje me nenin 130 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe nenin 7 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane. Banka e Shqipërisë dhe anëtarët e Këshillit të saj nuk do të kërkojnë dhe nuk do të marrin udhëzime nga institucionet, organet, zyrat ose agjencitë e Bashkimit Evropian, nga qeveritë e shteteve anëtare ose nga çdo organ tjetër, përveç kompetencave që i njihen Bankës Qendrore Evropiane sipas traktateve dhe statutit përkatës.

Dispozitat e këtij kapitulli përcaktojnë objektivat e Bankës së Shqipërisë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke ruajtur objektivin kryesor të stabilitetit të çmimeve dhe mbështetjen e stabilitetit financiar si objektiv dytësor, si dhe duke parashikuar mbështetjen e politikave të përgjithshme ekonomike të Qeverisë shqiptare dhe të Bashkimit Evropian në funksion të arritjes së objektivave të Bashkimit Evropian.

Në aspektin funksional, kapitulli rregullon pjesëmarrjen e Bankës në operacionet e tregut të hapur dhe operacionet e kreditit të Eurosistemit, administrimin e rezervave valutore, mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave euro kundër falsifikimit, mbikëqyrjen dhe licencimin e institucioneve të kreditit, ofrimin e asistencës me likuiditetit për institucionet të afta për të paguar detyrimet, që përballen me mungesa të përkohshme likuiditeti, si dhe ndalimin e kreditimit të sektorit publik. Ai përfshin gjithashtu detyrimet për raportim, statistika dhe sistemet e pagesave në përputhje me kërkesat e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Kapitulli forcon integrimin institucional të Bankës së Shqipërisë në strukturat e BQE-së, duke përfshirë pjesëmarrjen e Guvernatorit në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane, si dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e bashkëpunimit dhe konsultimit në fushën monetare dhe financiare. Ai rregullon gjithashtu shkëmbimin e informacionit, mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe çështjet e auditimit, në përputhje me rregullat e Eurosistemit. Në të njëjtën kohë, përcakton pjesëmarrjen në kapitalin e BQE-së dhe transferimin e rezervave valutore, duke garantuar përgatitjen e plotë institucionale të Bankës së Shqipërisë për integrimin në Eurosistem.

Ky kapitull shërben si një mekanizëm tranzicioni ligjor për momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke siguruar që Banka e Shqipërisë të jetë e gatshme të integrohet në arkitekturën institucionale dhe ligjore të Bashkimit Evropian, pa pasur nevojë për ndryshime të mëvonshme të menjëhershme në ligjin bazë.

Kapitulli XV – Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Monetar Evropian

Kapitulli XV përmban dispozita që do të hyjnë në fuqi nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Monetar Evropian dhe adoptimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë. Ky kapitull përcakton përshtatjen e mëtejshme të rolit të Bankës së Shqipërisë me funksionimin e Eurosistemit.

Ky kapitull përshtat funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë në një mjedis monetar ku euro është monedha zyrtare, duke e zhvendosur fokusin nga politika monetare kombëtare drejt pjesëmarrjes në politikën monetare të Eurosistemit. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë do të zbatojë detyrat e saj monetare në përputhje me vendimmarrjen dhe aktet e Bankës Qendrore Evropiane, duke u bërë pjesë e strukturës së përbashkët të politikës monetare të Bashkimit Evropian.

Kapitulli rregullon gjithashtu çështjet e emetimit dhe qarkullimit të euros, duke përcaktuar rolin e Bankës së Shqipërisë në hedhjen në qarkullim dhe tërheqjen e kartëmonedhave dhe monedhave euro, si dhe përshtatjen e dizajnit të monedhave sipas rregullave përkatëse të Bashkimit Evropian. Po ashtu, ai harmonizon përdorimin e instrumenteve të politikës monetare, përfshirë rezervat e detyrueshme dhe instrumentet e tjera të kontrollit monetar, me kuadrin rregullator të Bankës Qendrore Evropiane.

Një element i rëndësishëm i kapitullit është rregullimi i marrëdhënieve financiare dhe operacionale me Eurosistemin, përfshirë transferimin dhe administrimin e rezervave valutore drejt Bankës Qendrore Evropiane, si dhe menaxhimin e pjesës së mbetur të rezervave. Në të njëjtën linjë, kapitulli parashikon pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në kapitalin e Bankës Qendrore Evropiane dhe rregullat për administrimin e këtyre angazhimeve financiare.

Kapitulli forcon mekanizmat e bashkëpunimit institucional me Bankën Qendrore Evropiane, duke vendosur detyrimin për raportim, konsultim dhe zbatim të akteve, udhëzimeve dhe vendimeve të saj. Ai rregullon gjithashtu pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në procesin e statistikave, sistemet e pagesave, operacionet e jashtme dhe bashkëpunimin ndërkombëtar monetar, në përputhje me rolin e saj si pjesë e Eurosistemit.

Në aspektin institucional, kapitulli përcakton kompetencat e Këshillit të Bankës së Shqipërisë në kuadër të Eurosistemit, përfshirë miratimin e akteve të nevojshme për zbatimin e detyrave të saj, si dhe pjesëmarrjen e Guvernatorit në Këshillin Drejtues të Bankës Qendrore Evropiane. Gjithashtu, rregullohen çështjet e rezultatit financiar, shpërndarjes së fitimit dhe auditimit, duke siguruar përputhshmëri të plotë me standardet e BQE-së dhe praktikat e kontabilitetit të Eurosistemit.

Së fundi, kapitulli parashikon mekanizmat e zbatimit të detyrueshëm të akteve të Bankës Qendrore Evropiane dhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian, duke garantuar epërsinë e kuadrit të Eurosistemit në rast konflikti me dispozitat e brendshme. Në këtë mënyrë, ai krijon bazën ligjore për një tranzicion të plotë dhe të pandërprerë të Bankës së Shqipërisë nga një bankë qendrore kombëtare në një autoritet integral të Eurosistemit.

Ky kapitull krijon kuadrin e nevojshëm ligjor për fazën më të avancuar të integritetit monetar të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar kalimin e Bankës së Shqipërisë nga pjesëmarrja në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore në pjesëmarrjen e plotë në Eurosistem, pas adoptimit të monedhës së përbashkët EURO.

Kapitulli XVI– Dispozita tranzitore dhe të fundit

Kapitulli XVI përmban dispozitat tranzitore dhe rregullime të fundit të projektligjit dhe ka si qëllim të sigurojë kalimin e rregullt, të sigurt dhe juridikisht të qëndrueshëm nga kuadri aktual ligjor e rregullator në atë të ri të Bankës së Shqipërisë. Ky kapitull përfaqëson një komponent thelbësor të projektligjit, pasi garanton vazhdimësinë institucionale, shmang krijimin e boshllëqeve ligjore dhe siguron që procesi i zbatimit të ligjit të ri të kryhet pa cenuar ushtrimin normal të funksioneve të Bankës së Shqipërisë.

Dispozitat tranzitore rregullojnë mënyrën se si do të trajtohen marrëdhëniet juridike, vendimet, aktet rregullatore, procedurat administrative dhe strukturat ekzistuese të krijuara në bazë të ligjit aktual. Nëpërmjet këtyre dispozitave synohet të ruhet siguria juridike dhe të shmangen pasojat që mund të lindnin nga një ndryshim i menjëhershëm i kuadrit ligjor. Në veçanti, parashikohet që aktet e nxjerra dhe vendimet e marra në bazë të legjislacionit ekzistues të vazhdojnë të mbeten në fuqi për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit të ri ose deri në zëvendësimin e tyre me akte të reja.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij kapitulli lidhet me garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të organeve drejtuese dhe të strukturave administrative të Bankës së Shqipërisë. Duke qenë se projektligji sjell ndryshime të rëndësishme në organizimin, kompetencat dhe qeverisjen e institucionit, dispozitat tranzitore krijojnë mekanizmat e nevojshëm për të shmangur ndërprerje në ushtrimin e funksioneve të bankës qendrore dhe për të garantuar stabilitet institucional gjatë periudhës së tranzicionit.

Kapitulli rregullon gjithashtu afatet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve me natyrë rregullatore që kërkohen për zbatimin e plotë të ligjit. Këto dispozita kanë rëndësi të veçantë, pasi sigurojnë që kuadri i ri ligjor të shoqërohet me instrumentet rregullatore të nevojshme për zbatimin praktik të tij.

Një rol të veçantë luajnë dispozitat që lidhen me shfuqizimin e legjislacionit ekzistues. Kapitulli përcakton qartë aktet ligjore ose dispozitat që shfuqizohen me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, duke siguruar koherencë të sistemit juridik dhe duke eliminuar mundësinë e mbivendosjes së normave apo të konflikteve ndërmjet dispozitave të vjetra dhe atyre të reja. Kjo qasje kontribuon në rritjen e qartësisë dhe sigurisë juridike për të gjitha subjektet që ndërveprojnë me Bankën e Shqipërisë.

Për më tepër, dispozitat e fundit kanë funksionin e përcaktimit të momentit të hyrjes në fuqi të ligjit dhe të rregullimit të çdo çështjeje tjetër që është e nevojshme për zbatimin efektiv të tij. Përvoja ndërkombëtare dhe praktikat e mira legjislative tregojnë se dispozitat tranzitore dhe rregullime të fundit janë veçanërisht të rëndësishme në rastet kur ligji reformon në mënyrë të gjerë statusin, kompetencat dhe strukturën e institucioneve kryesore publike, siç është banka qendrore.

Në kontekstin e këtij projektligji, dispozitat tranzitore dhe ato të fundit marrin një rëndësi edhe më të madhe për shkak të modernizimit të kuadrit ligjor të Bankës së Shqipërisë dhe përafrimit të tij me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të bankave

qendrore. Këto dispozita sigurojnë që ky proces reformues të realizohet në mënyrë graduale, të kontrolluar dhe pa pasoja negative për stabilitetin institucional, financiar dhe operacional të Bankës së Shqipërisë.

Neni 112 rregullon mënyrën e realizimit të rritjes fillestare të kapitalit të nënshkruar të Bankës së Shqipërisë deri në vlerën 6 miliardë lekë. Dispozita parashikon që kjo rritje të kryhet në radhë të parë nga rezervat e veçanta të krijuara nga fitimet e vetë Bankës së Shqipërisë, ndërsa vetëm në rastin kur këto rezerva nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shumën e përcaktuar, diferenca financohet nga Ministria e Financave.

Qëllimi i kësaj dispozite është të sigurojë që Banka e Shqipërisë të disponojë një bazë kapitale të përshtatshme dhe të qëndrueshme, në përputhje me funksionet, përgjegjësitë dhe rreziqet që mbart një bankë qendrore moderne. Kapitali i mjaftueshëm përfaqëson një nga shtyllat kryesore të pavarësisë financiare të bankës qendrore dhe është një element thelbësor për besueshmërinë e saj institucionale, kapacitetin për të absorbuar humbje të mundshme financiare dhe aftësinë për të ushtruar mandatin e saj pa u ekspozuar ndaj presioneve të jashtme.

Dispozita është ndërtuar mbi parimin që, përpara se të përdoren fonde publike shtesë, duhet të shfrytëzohen burimet e krijuara nga vetë veprimtaria e Bankës së Shqipërisë. Kjo qasje pasqyron parimet e administrimit të kujdesshëm financiar dhe të përdorimit efikas të burimeve ekzistuese të institucionit. Nga ky këndvështrim, përdorimi i rezervave të krijuara nga fitimet e Bankës përbën zgjidhjen më natyrale dhe më pak të kushtueshme për shtetin, pasi kapitalizimi realizohet fillimisht nga burime të krijuara brenda vetë institucionit.

Në të njëjtën kohë, dispozita garanton që procesi i kapitalizimit të mos mbetet i papërfunduar në rast se rezervat ekzistuese rezultojnë të pamjaftueshme. Për këtë arsye, projektligji parashikon detyrimin e Ministrisë së Financave për të siguruar pjesën e mbetur të kapitalit të nevojshëm. Ky mekanizëm garanton që niveli i kapitalit i parashikuar nga ligji të arrihet plotësisht dhe brenda afateve të nevojshme për zbatimin e kuadrit të ri ligjor.

Nga pikëpamja e praktikave ndërkombëtare, ekzistenca e një baze kapitale të përshtatshme konsiderohet një element i rëndësishëm i pavarësisë financiare të bankës qendrore. Institucionet financiare ndërkombëtare, bankat qendrore moderne dhe Sistemi Evropian i Bankave Qendrore theksojnë rëndësinë që bankat qendrore të disponojnë burime financiare të mjaftueshme për të ushtruar funksionet e tyre, për të përballuar rreziqet financiare që rrjedhin nga operacionet monetare dhe valutore, si dhe për të ruajtur besueshmërinë e tyre në tregjet financiare.

Për më tepër, rritja e kapitalit të nënshkruar nuk ka si qëllim krijimin e fitimeve ose sigurimin e përfitimeve financiare për shtetin si pronar i Bankës, por forcimin e pozicionit financiar të institucionit. Duke qenë se Banka e Shqipërisë ushtron funksione me rëndësi sistemike për ekonominë kombëtare, disponimi i një niveli të mjaftueshëm kapitali përbën një garanci shtesë për vazhdimësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së saj.

Në këtë kuptim, neni 112 përfaqëson një dispozitë tranzitore me rëndësi të veçantë, e cila siguron që hyrja në fuqi e kuadrit të ri ligjor të shoqërohet me forcimin e bazës financiare të

Bankës së Shqipërisë. Dispozita kontribuon në rritjen e rezistencës financiare të institucionit, në mbështetjen e pavarësisë së tij dhe në përafrimin e mëtejshëm me standardet dhe praktikatat më të mira të bankave qendrore moderne.

Në tërësi, Kapitulli XVI garanton që kalimi nga kuadri aktual ligjor në kuadrin e ri të realizohet në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, duke ruajtur vazhdimësinë e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë, sigurinë juridike dhe efektivitetin e zbatimit të reformës së propozuar. Për këtë arsye, ai përbën një element të domosdoshëm të projektligjit dhe një garanci të rëndësishme për zbatimin e tij të suksesshëm në praktikë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Në kuadër të zbatimit të këtij ligji, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet organeve të saj drejtuese dhe strukturave të brendshme, do të jetë përgjegjëse për nxjerrjen e akteve normative, rregullatore dhe akteve të tjera të nevojshme për zbatimin e ligjit, organizimin e veprimtarisë institucionale, administrimin e burimeve financiare dhe njerëzore, si dhe ushtrimin e funksioneve të saj në fushën e politikës monetare, administrimit të rezervës valutore, sistemeve të pagesave, emetimit të monedhës, mbikëqyrjes bankare dhe stabilitetit financiar.

Për zbatimin e dispozitave që lidhen me marrëdhëniet ndërinstitucionale, financat publike, emetimin dhe administrimin e borxhit publik, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin institucional, ngarkohen, sipas fushës së përgjegjësisë, edhe Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për financat, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe subjektet e tjera publike, të cilat duhet të respektojnë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë dhe ndalimin e financimit monetar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Në rastet kur ligji parashikon pjesëmarrje, konsultim, raportim ose bashkëpunim me institucione të tjera vendase, të huaja apo ndërkombëtare, këto institucione dhe autoritete do të veprojnë brenda kompetencave të tyre ligjore, duke siguruar shkëmbimin e nevojshëm të informacionit dhe bashkëpunimin efektiv me Bankën e Shqipërisë.

Për dispozitat që do të zbatohen pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe pas adoptimit të euros, zbatimi do të kryhet nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Bashkimit Evropian, përfshirë Bankën Qendrore Evropiane, sipas kushteve, procedurave dhe afateve të përcaktuara nga traktatet, Statuti i Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe i Bankës Qendrore Evropiane, si dhe aktet e zbatueshme të Bashkimit Evropian.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Banka e Shqipërisë dhe propozohet nga Ministria e Financave. Në procesin e hartimit dhe rishikimit të projektligjit është përfituar asistencë teknike nga misioni i posaçëm i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe nga Banka Qendrore e Luksemburgut,

të cilët kanë kontribuar me ekspertizë në drejtim të përafrimit të kuadrit ligjor për Bankën e Shqipërisë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për bankat qendrore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji, në tërësi, nuk parashikon krijimin e të ardhurave të reja buxhetore dhe nuk krijon efekte financiare shtesë të drejtpërdrejta për buxhetin e shtetit. Dispozitat e tij kanë kryesisht karakter institucional, organizativ, rregullator dhe harmonizues, duke synuar përditësimin e kuadrit ligjor për Bankën e Shqipërisë dhe përafrimin e tij me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për bankat qendrore.

Zbatimi i projektligjit do të realizohet kryesisht nga Banka e Shqipërisë dhe organet e saj drejtuese, brenda strukturave, kapaciteteve administrative dhe burimeve financiare të institucionit. Në këtë këndvështrim, projektligji nuk kërkon krijimin e strukturave të reja buxhetore, nuk vendos skema të reja financimi publik dhe nuk sjell nevojë për alokime të përgjithshme shtesë nga buxheti i shtetit për funksionimin e Bankës së Shqipërisë.

Në lidhje me nenin 112 të projektligjit, duhet theksuar se rritja fillestare e kapitalit të nënshkruar të Bankës së Shqipërisë deri në shumën 6 miliardë lekë është konceptuar si një masë për forcimin e bazës financiare dhe të pavarësisë së bankës qendrore, dhe jo si një shpenzim i zakonshëm buxhetor për financimin e veprimtarisë së saj operative. Dispozita parashikon që kjo rritje të realizohet në radhë të parë nga rezervat e veçanta të krijuara nga fitimet e vetë Bankës së Shqipërisë, duke përdorur burime të brendshme të institucionit përpara çdo angazhimi nga buxheti i shtetit.

Në këtë kuptim, efektet e pritshme me hyrjen në fuqi të dispozitave të këtij projektligji, përfshijnë: Kapitali i nënshkruar i Bankës së Shqipërisë rritet në 6 miliardë lekë nga 2,5 miliardë që është aktualisht. Efekti i rritjes është 3,5 miliardë lekë. Rezerva e Përgjithshme bazuar në ligj, duhet të arrijë 500 % vlerën e Kapitalit të nënshkruar, kjo do ta shpjerë vlerën e Rezervës së Përgjithshme në 30 miliardë lek nga 12,5 miliardë që është aktualisht. Efekti i rritjes do të jetë 17,5 miliardë lek. Nevoja totale për fonde me qëllim arritjen e rritjes së Kapitalit sipas dispozitave të projektligjit është 21 miliardë lekë. Aktualisht teprica e rezervës speciale me qëllim forcimin e kapitalit, krijuar nga fitimet e viteve 2023 dhe 2024 është në vlerën e 29,6 miliardë lekë.

Vetëm në rast se rezervat e veçanta të krijuara nga fitimet e Bankës së Shqipërisë nuk rezultojnë të mjaftueshme për të mbuluar plotësisht rritjen e kapitalit të nënshkruar, projektligji parashikon që diferenca të mbulohet nga Ministria e Financave. Ky parashikim ka karakter plotësues dhe garancie, me qëllim që niveli i kapitalit të përcaktuar me ligj të arrihet në mënyrë të plotë dhe të sigurt. Për rrjedhojë, angazhimi eventual i Ministrisë së Financave nuk përbën një efekt të përgjithshëm dhe të menjëhershëm buxhetor, por një mekanizëm subsidiar që aktivizohet vetëm nëse burimet e brendshme të Bankës nuk janë të mjaftueshme. Rezerva e

Përgjithshme, do të mund të rritet nga fitimet e periudhave në vijim dhe/apo rezervat e veçanta të krijuara nga Banka deri sa të arrijë nivelin minimal të parashikuar në ligj, që është sa 500% e Kapitalit të Nënshkruar.

Nga pikëpamja buxhetore, ky mekanizëm duhet vlerësuar në lidhje me natyrën e veçantë të Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore dhe me nevojën për të garantuar pavarësinë financiare të saj. Kapitali i mjaftueshëm nuk shërben për krijimin e përfitimeve financiare apo për financimin e shpenzimeve korrente, por për forcimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, rritjen e aftësisë për të përballuar rreziqe të mundshme dhe ruajtjen e besueshmërisë së tij në ushtrimin e funksioneve me rëndësi sistemike për ekonominë dhe sistemin financiar.

Në përfundim, vlerësohet se miratimi dhe zbatimi i projektligjit nuk krijon efekte negative apo të pakontrolluara për buxhetin e shtetit. Çdo efekt i mundshëm financiar që lidhet me nenin 112 është i kufizuar, i kushtëzuar dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektivin e forcimit të kapitalit të Bankës së Shqipërisë, duke u mbështetur fillimisht në burimet e vetë institucionit dhe vetëm në mënyrë plotësuese në financimin nga Ministria e Financave, në rast pamjaftueshmërie të këtyre burimeve.

MINISTRI

Petrit Malaj